



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.10.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 01. 10. 2019.
2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” (*Albanian Investment Corporation*), iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Krenar Rryci, Ervin Bushati, Evis Kushi, Arben Elezi, Korab Lita, Xhevit Bushaj, Blerina Gjylameti, Sadi Vorpsi, dhe Dritan Bici, Eljo Hysko

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Roland Xhelilaj dhe Ylli Shehu.

Të ftuar:

Ministria e Financave

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Saimir Muçmataj – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arvid Uruçi – Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj - (*Mungesë incizimi*) ...të vendosur në e-mail-e zyrtare, të dërguara nga sekretaria dhe shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për korporatën e investimeve shqiptare”, siç i referohet rëndom në anglisht *Albaninan Investment Corporation*, iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Relatore është zonja Reme Lala.

Të ftuar nga Ministria e Financave janë: zoti Elton Haxhi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, zoti Saimir Muçmataj, drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe zoti Arvid Uruçi, përgjegjës sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Për të informuar komisionin, siç e dini misioni i Komisionit European në Tiranë, ka bërë rekomandimet e tij për sa i përket draftit në funksion të përmirësimit, ndryshime, të cilat do t’i kalojmë nen për nen sot së bashku.

Sekretaria e komisionit, zonjat Alma, Elvi dhe Ervina në fund të procesit të rakordojnë me Ministrinë e Financave dhe të kuadroni ndryshimet.

Ka ndonjë koment nga anëtarët e komisionit për procesverbalin e datës 1 tetor?

Nëse nuk ka, quhet i miratuar.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen të projektligjit. Si procedurë për deputetët e rinj, nëse më lejoni në respektin tuaj, për çdo nen, mund të bëni pyetjet dhe mund të propozoni ndryshime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t’i kërkoj sekretarit të komisionit që të shënojë sipër: “varianti i përmirësuar” për të gjithë deputetët.

Më falni, kam nevojë për qetësi!

Neni 1 “Qëllimi”. Nuk ka ndryshime nga varianti zyrtar. Ka pyetje apo ndonjë koment kolegë deputetë? Nuk ka.

Do t’ju lutem të jemi sa më racionalë që të punojmë kryesisht teknikisht, sepse në parim ne e diskutuam në mbledhjen e kaluar.

Kush është dakord? Kundër ? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Objektivat e korporatës”. Nuk ka ndryshime. Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi jemi te diskutimi nen për nen, sepse e kemi zhvilluar një seancë diskutimi dhe të pyetjeve në parim. Kemi diskutuar 2 orë e 20 minuta. Keni bërë në legjitimitetin tuaj pyetjet e duhura edhe përtej draftit apo politikisht të motivuara. Kjo është legjitime dhe nuk diskutohet fare.

Do t'ju lutesha që në respekt të procedurës, por edhe të punës sonë të jemi të përqendruar teknikisht. Ka pyetje për këtë nen?

Artur Roshi – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti zëvendësministër, si përfaqësues i qeverisë, a mund të dimë pse keni vendosur emrin “korporatë” dhe jo “ndërmarrje shtetërore”? Ku është ndryshimi sipas jush?

Arben Ahmetaj - Po, zoti Zëvendësministër.

Ju lutem, sa më konciz!

Elton Haxhi – Duke u bazuar edhe në praktikën ndërkombëtare termi “korporatë” është gjendur më i përshtatshëm për këtë institucion, duke qenë se ka të gjitha nivelet e administrimit dhe të kontrollit të brendshëm, ka një strukturë të plotë dhe është më bashkëkohor si terminologji.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Ka pyetje tjetër?

Artur Roshi - Me përkufizimin “korporatë” do të quajmë shoqëri aksionere të madhe që rrit fitimin, ndërsa këtu nuk kemi shoqëri aksionere. Pra, ke formën e kapitalizmit dhe substancën e socializmit të ndërmarrjeve shtetërore. Ti ke një ndërmarrje shtetërore dhe thjesht i vendos kapelën lart dhe e quan korporatë. Korporatë do të thotë përfaqësues, aksionerë të ndryshëm, ti cilin ke aksioner? Ke vetëm shtetin. E ke ndërmarrje shtetërore.

Arben Ahmetaj – Zoti Zëvendësministër, një sekondë!

Zoti Roshi bëri pyetjen pse është korporatë. Ju i kthyet përgjigjen e drejtë. Unë po bëj edhe një sqarim në vazhdim të pyetjes suaj. Është shoqëri aksionere, pasi në finale ligji i jep autorizimin, ai është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më ndërprisni! Ju lutem!

Në bazë të definicionit të shoqërive tregtare mund të ketë një aksioner, por mund të ketë shumë të tillë.

(Zhurmë në sallë)

Djema, nëse keni ardhur këtu për të bërë zhurmë...

Mos ma drejto kamerën mua kur të flas ty...

Fokusohuni këtu, nëse jeni të interesuar për mbledhjen e komisionit. Po bëni muhabet, zhurmë. I bie të mbajmë qetësi edhe për ju!

Pra, nuk ka rëndësi, nëse janë një apo 10 aksionerë. Është shoqëri tregtare, nesër po në bazë të ligjit “Për shoqëritë tregtare” dhe kjo është shumë e qartë. Kjo është arsyeja pse i është vendosur emri “korporatë”.

Ka pyetje tjetër për nenin 2? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Kemi disa ndryshime, të cilat unë i kam edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Anëtarë të komisionit, nga pozita dhe opozita, kemi një tabelë ku me vëmendje mund të shikoni ndryshimet, në mënyrë që të jemi racionalë teknikisht.

Në nenin 3, germa “f” është bërë një shtesë, ku me anë të ligjit është përcaktuar se korporata në funksionim të saj do të zbatojë legjislacionin për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore. Është një shqetësim legjitim, që edhe pozita, edhe opozita e shprehën herën e kaluar. Komisioni European e ka referuar si të ne, ashtu edhe të Ministria e Financave. Këtu kemi bërë ndryshimet, ku thuhet “Në përputhje me kuadrin ligjor “Për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore”. Pra, atij që iu referua zoti Roshi për termin “korporatë”, tani po e shtojmë akoma më tej në drejtim të pavarësisë dhe të transparencës. Siç e theksova ky rregullim është bërë duke pasur parasysh edhe komentet e FMN-së, Bankës Botërore dhe BERZH-it. Ndërkohë, unë vetë kam edhe disa ndryshime në këtë nen. E kam shkruar së bashku me ju draftin, por patjetër këta muaj kemi evoluar dhe kemi pranuar edhe vërejtjet e mëtejshme nga institucionet ndërkombëtare.

Në germen “a” thuhet: “Përparësia e zhvillimit ekonomik dhe social në nivel qendror, vendor dhe rajonal, si dhe lidhjet me politikat shtetërore të zhvillimit”. Kjo është korporatë. Termi “social” bie me qëllim që korporata të mos bëjë nesër projekte sociale. Korporata ka përgjegjësinë sociale si çdo korporatë, por jo të marrë përsipër projekte sociale. Pastaj shkojmë te shqetësimi që kanë pozita dhe opozita, pra i bie që mund të keqpërdoret për ndonjë projekt social. Unë kërkoj nga ministria të reflektohet ky ndryshim, pasi të votohet.

Do t’ju lutem deputetëve, sepse do të votojmë edhe këto ndryshime, të mos jetë fjala “social”.

Cili është meraku im dhe i FMN-s? Nesër meqenëse është 100% shtetërore qeveria mund t'i japë në kurriz një projekt social, i cili nuk ka në themel përfitueshmërinë. I bie që të shtrembërohet funksionaliteti i kapitalit, pse është krijuar. Nuk është një fond social.

Mos bëni debate!

Edlira Hyseni - A mundet të jap opinionin tim?

Arben Ahmetaj - Po, por jo për ndryshimet e mia.

Edlira Hyseni - Ne këto po komentojmë.

Arben Ahmetaj - Voto kundër ose pro.

Edlira Hyseni - Ne mund të kemi opinion për atë që ju propozoni, qoftë edhe për kolegët për t'i ndihmuar në vendimmarrje.

Arben Ahmetaj - Dakord.

Edlira Hyseni – Nëse ju thoni se mund të ndodhë ai rasti që korporatës t'i ngarkohen projekte sociale, mund të jetë një rast në nuk e di sesa milionë raste të tjera. Por nëse ne në parim themi se kjo korporatë do të zhvillojë pronat publike, shtetërore, po u themi qytetarëve: “Kjo korporatë do të zhvillojë pronat kudo ku ato janë sot, të bashkive, të ministrive. Nesër këto prona përveç se do të zhvillojnë ekonomikisht vendin do të kenë edhe një impakt social më të mirë dhe qytetarët mund ta mirëpresin këtë privatizim sesa thjesht anën ekonomike. Pse të ketë vetëm qëllim fitimprurjen? Korporata patjetër që i jep zhvillim vendit edhe nga ana sociale. Pra, qytetarët do të mirëprisnin edhe anën sociale përveçse fitimprurjen, anën ekonomike. Unë mendoj se kjo e zbut pak impaktin që ajo ka.

Arben Ahmetaj – Dakord, e tërheq ndryshimin.

Artur Roshi - Ideja është që korporata vjen për të fituar, nuk vjen për të mbuluar plagët sociale të shoqërisë. Është një korporatë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pavarësisht se unë jam tërësisht kundër kësaj. Pra, kjo është një korporatë, që vjen për të rritur fitimet e saj. Nuk mund të mbulojë çështjet sociale, që do të thotë se nuk kujdeset për çështje të ndryshme sociale. Kështu funksionojnë kompanitë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, por ky nuk është një instrument social.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shteti ka politika sociale, e tha shumë drejtë zonja Gjylameti, ka instrumente të tjerë. A do të ketë kjo korporatë përgjegjshmërinë sociale të korporatë? Të gjitha korporatat e kanë,

dhe është një nen më poshtë, por korporata duhet të jetë strikt, kështu siç e ka nisur qeveria si ide.

Kush është dakord me këtë ndryshim?

Faleminderit!

Ndryshimi tjetër në nenin 3, përtej ndryshimeve që reflektohen në tabelën që keni përpara, është që të shtohet pika 'c'. Pra, pas pikës 'b', të shtohet pika 'c', që do të thotë se korporata udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: 'a', 'b', 'c': përfitueshmëria, fizibiliteti ekonomik dhe tregtar i projekteve. Pra, është shtesë tek neni 3.

Pra, për ta bërë akoma më puntuale, në parimet e përgjithshme të ketë parim përfitueshmërinë, fizibilitetin ekonomik dhe tregtar. Kjo i referohet shqetësimit që ka pasur Banka Botërore, Fondi Monetar. Kjo korporatë nuk krijohet si një xhep për të devijuar para buxheti, sepse, le të themi, ia kemi mbyllur rubinetin. Ne e detyrojmë që të jetë një korporatë, e cila të funksionojë me përfitueshmëri, në mënyrë që të prodhojë para *prim* në funksionin e vet. Pra, të maksimizojë komplet fitimin dhe shfrytëzimin e aseteve.

Jeni dakord me këtë ndryshim që u propozua?

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, ta mbaroj edhe këtë.

Shtojmë edhe pikën 'd'.

Arvid, Saimir, në ndihmë të zëvendësministrit dhe të sekretarisë.

Pika 'd'. Korporata udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: Parimi i ruajtjes dhe zhvillimit të vlerës së aseteve. Pse? I përgjigjet një shqetësimi të natyrshëm, që ka pasur Kryeministri, kur ka parë draftin me vëmendje, si dhe të gjithë ne. Do të kalojnë asete nga qeveria? Po çfarë ndodh me këto asete? Vijnë me vlerën historike kontabël X, dhe pastaj shkojnë në X minus? Jo. Korporata ka si qëllim t'i rrisë vlerën, t'ia mbajë dhe t'u rrisë vlerën edhe aseteve gjithashtu.

Pra, te paketa e parimeve të përgjithshme jemi duke drejtuar korporatën, një korporatë në vetvete, jo një instrument të qeverisë për të bërë thjesht projekte, të cilat vijnë e dalin përpara, që kanë efekte të ndryshme sociale apo të paqarta, le të themi. Jo. Kjo e qartëson akoma më shumë, në bazë të parimeve.

Kush është pro këtij ndryshimi? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe ky ndryshim.

Me ndryshimet që kemi në tabelë dhe ndryshimet që unë propozova, të cilët u miratuan tek për tek nga ana juaj, kush është pro nenit 3? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kaloi edhe neni 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, kaloi. S'ishit juve, por s'ka gjë, se shqetësimi juaj u përfaqësua me dinjitet nga pozita dhe opozita.

Neni 4.

Kush ka pyetje te neni 4? Zoti Roshi.

Artur Roshi – Si do ta respektojë kjo korporatë parimin e konkurrencës së lirë në treg, kur mbrapa ka shtetin?

Zoti zëvendësministër, po dëgjoni apo...

Arben Ahmetaj – Zëvendësministri është përfaqësues dinjitoz i ministrisë, kështu që, dua respekt të plotë nga ana e komisionit për zëvendësministrin.

Artur Roshi – Absolutisht po, po kur s'e ka mendjen...

Arben Ahmetaj – E ka mendjen full time. Zëvendësministri e ka mendjen edhe kur s'e kanë të tjerët, jo më kur mendja është e fokusuar. Vazhdojmë.

Artur Roshi – Pra, si do ta respektojë kjo korporatë parimin e konkurrencës së lirë në treg, kur mbrapa ka shtetin? Si e kuptoni ju pavarësinë në vendimmarrjet e saj.

Arben Ahmetaj – Po, zoti zëvendësministër.

Elton Haxhi – Nenin 3?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por te neni 3...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por po them se te neni 3 ishte një nga ndryshimet e bëra te ky version, ku korporata zbaton legjislacionin për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore.

Arben Ahmetaj – Pra, zoti Roshi, prandaj e shtuam atë dhe e theksuam.

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Po, zonjë.

Edlira Hyseni – Faleminderit!

Unë e bëra pyetjen edhe një herë tjetër, por dëshiroj ta ribëj. Te neni 4, pika 3, përcaktohet se përveç shtetit, që është aksioner kryesor, parashikohet që me VKM të posaçme të jenë edhe institucione të tjera financiare ndërkombëtare të zhvillimit.

Pra, me këtë nen, ligji përcakton qartë këta dy aksionerë të mundshëm. A mjafton kjo për të përjashtuar apriori, në mënyrë të padiskutueshme, që me VKM, Këshilli i Ministrave të parashikojë edhe aksionerë të tjerë, përveç këtyre të dyve: shtetit dhe institucioneve ndërkombëtare? Përjashtohet totalisht, apo mbetet e mundshme që VKM-ja të mund të përdoret në këtë rast?

Arben Ahmetaj – Zoti zëvendësministër, s’ka problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju e bëtë pyetjen. Pse dy herë? Të dukemi sikur s’e kuptojmë pyetjen? Ti je gjithmonë shumë e qartë, dhe ne e kuptojmë pyetjen. Në rregull!

Pra, ligji ka vënë kufizime edhe për atë shqetësim që keni pasur juve, në lidhje me konkurrencën dhe qëllimin që ka korporata për projekte specifike, si një urë midis privatit dhe shtetit, ndaj ka limituar mundësinë e pjesëmarrësve vetëm te institucionet financiare ndërkombëtare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duro, Vullnet, do të vijmë tek ti, sepse po japim përgjigje.

Këto janë. Pra, jo palë të tjera. Mund të jetë krahu korporativ i Bankës Botërore, IFC-ja, mund të jetë BERZH-i, mund të jetë BEI. Pra, janë institucione të njohura financiare ndërkombëtare të zhvillimit. I ktheva një përgjigje edhe zotit Roshi.

Në të ardhmen, nëse kjo korporatë, sikundër besojmë e shpresojmë, do të jetë shumë e suksesshme, një komision si ky, me ne apo me deputetë të tjerë, do të mbledhet dhe do të gjykojë nesër, por sot, me ligj, me këtë draftligj, ne e kufizojmë.

Pyetje tjetër për nenin 4?

Po, zoti Vullnet.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, kryetar!

Te pika 3 thuhet se institucionet financiare ndërkombëtare të zhvillimit mund të zotërojnë aksione të korporatës. Pse të mos zotërojnë edhe privatët aksione në korporatë?

Arben Ahmetaj – I dhamë përgjigje kësaj.

Zoti zëvendësministër, vetëm kur t’ju jap leje unë.

I dhamë përgjigje kësaj pyetjeje. Ka pyetje tjetër? Jo.

Atëherë, kush është pro nenit 4, me ndryshimet? Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kalojmë te neni 5.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni 5...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gëzuar ditëlindjen, zonjë! U bëfsh qindra! Paç një jetë të lumtur, me gjithë familjen, miqësinë pjesën e grupit tënd parlamentar, por edhe me opozitën!

Vëmendje te neni 5.

Pra, neni 5 i variantit zyrtar spostohet, bëhet neni 6, dhe kemi një nen të ri, ku janë funksionet e korporatës. Ky nen është shkruar në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore, Komisionin Europian, për të davaritur të gjitha ato pikëpyetje legjitime që mund të ketë secili prej nesh, apo përtej nesh.

Jemi dakord, si koncept? Pra, te neni 5 do të jenë funksionet e korporatës. Funksionet e korporatës janë ato që janë. Unë po i lexoj vetëm për regjistrim.

Ministria, më ndiqni, ju lutem, sepse do të rakordoni me sekretarinë.

Funksionet kryesore të korporatës janë:

1-Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave dhe projekteve, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.

2-Këshillimi i institucioneve publike ose private, në hartim, analizim dhe rekomandim të projekteve.

3-Financimi ose bashkëfinancimi i projekteve ose subjekteve për qëllime të veçanta, SPV-të ngritura për realizimin e tyre, me autorizim të Këshillit të Ministrave, merr rolin e zhvilluesit, sipas legjislacionit për zonat teknologjike dhe zhvillimin ekonomik.

4-Këshilli i Ministrave mund ta autorizojë korporatën, që të kryejë funksione të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

Tani, ky është një nen, i cili është përpunuar me institucionet, për ta qartësuar më tej, për ta davaritur atë pikëpyetje.

Nëse ka pyetje për nenin 5, të shtuar...

Pra, e para: a bini dakord, që ta shtojmë këtë nen?

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet shtimi i këtij neni.

Artur Roshi – E kam radhën, kryetar?

Arben Ahmetaj – Ju lutem, patjetër.

Artur Roshi – Zoti zëvendësministër, për sa i përket bashkëpunimit të korporatës me privatët, mos keni këtu modelin e PPP-ve, në përmasa më të vogla, për çdo investim korporatë-privat?

Arben Ahmetaj – Po, zoti zëvendësministër.

Elton Haxhi –Jo, bashkëpunimi nuk është sipas modelit të PPP-ve. Në nenin që sapo lexoi kryetar, në pikën ‘c’: “Financimi ose bashkëfinancimi i projekteve a subjekteve për qëllime të veçanta, SPV-të e ngritura për realizimin e tyre.”

Kjo presupozon që, për një projekt të caktuar do të bëhet studimi i fizibilitetit, do të dalin nevojat e financimit, dhe secili partner, në raport me kontributin që do të japë, do të ketë edhe përfitueshmërinë. Kjo në terma të përgjithshme. Pastaj, detajet janë vetë sipas studimit të fizibilitetit.

Artur Roshi – Pyetje tjetër: Sipas jush, ku ndryshon partneriteti publik privat nga partneriteti korporatë apo ndërmarrje shtetërore – privat?

Arben Ahmetaj – Zoti zëvendësministër.

Elton Haxhi – Në rastin për të cilin po flasim, atë të ndërmarrjeve për qëllime të veçanta, është një partneritet si gjithë të tjerët, ku secili merr pjesën që i takon, në raport me kontributin.

Arben Ahmetaj – Zoti zëvendësministër, në këtë rast...

Elton Haxhi – Nuk ka transferim risqesh tek njëra palë apo tek tjetra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Jo, jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi duke folur për një korporatë, e cila, për projekte specifike, me pjesëmarrje... Sa për ta ilustruar, projekti 1, zonë ekonomike, projekti 1, ku do të jetë pjesëtar, pjesëmarrës, së bashku me palët e treta krijon një entitet të ri, një SPV në rastin konkret pra, këtu nuk ka transferime risku te korporata apo te shteti. Nuk ka lidhje fare, se shteti qëndron larg.

Së dyti, është një ndërmarrje purifikisht me të drejtë private, pavarësisht kapitalit. Ata, që e njohin teknikalitetin e legjislacionit të shoqërive tregtare, e kuptojnë drejt se çfarë jam duke thënë, por po e shpjegoj më thjesht. Pavarësisht se ka kapital shtetëror, do të veprojë në bazë të ligjit të shoqërive tregtare, duke respektuar totalisht të drejtën private, nuk ka rëndësi kapitali.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, të mos bëjmë debate pafund se janë të detajuara, por patjetër për t'u sqaruar deri në fund mund ta vazhdojmë debatin. Pra, nuk ka lidhje fare PPP-ja.

Së pari, jemi të fokusuar te ky ligji dhe nuk duhet të flasim për PPP-të. Për shembull, Rruga e Arbrit, kur të mbarojë, të gjithë qytetarët e qarkut të Dibrës do të jenë njerëz të lumtur dhe i bie që të keni furnizuar logjikën e PPP-së, pra çfarë të mire i sjellë gjithë qarkut. Kjo nuk ka lidhje me fare me PPP-në, as me koncesionet, është e drejtë private dhe pavarësisht nga kapitali, është shoqëri tregtare, është korporatë.

Artur Roshi - Në relacionin mbështetës të këtij projektligji thuhet: “Një nga qëllimet e krijimit të kësaj korporate është “të marrë risqet ose të pamundësisë së hartimit të projekteve të bizneseve private.” Pra, çfarë është kjo ndërmarrje shtetërore që merr përsipër risqet e privatëve? Logjika është fare e thjeshtë: kemi një lloj të PPP-je, por të minimizuara në drejtime të ndryshme për zhvillime pronash të ndryshme.

Më tej në relacion thuhet: “Kemi iniciativa të privatëve për të zhvilluar prona të ndryshme shtetërore”. Këto mos janë ofertat e pakërkuara, por për prona më të vogla? Domethënë, këtu përveç PPP-ve të mëdha, që kanë zaptuar të gjithë pjesën kryesore të ekonomisë së vendit, kemi edhe këto të voglat ndoshta për këta kandidatët për oligarkët, por më vonë do të shprehem më qartë për to.

Arben Ahmetaj – Mirë se erdhët, zoti Ervin!

Faleminderit, që erdhët në komision! E ke bërë zakon që vjen në orë fiks, pra mbledhja është në 10:00, ju vini fiks në orën 10:37, pra vini fiks në kohë! Mos flisni pa leje, sepse komisioni ka shumë respekt për fjalën tuaj në vazhdimësi. Pozita dhe opozita ndalon t'ju dëgjojë kur ju flisni. Mos i ndërhyri deputetit.

Urdhëroni!

Ervin Bushati – Më duket se te debatet nen për nen po futemi shumë në koncepte, aq më tepër që po dalim me premisa të gabuara në pikëpamjen tonë. Për ju i gjithë ligji është i ndërtuar gabim, në qoftë se futemi në çdo nen për të sqaruar pikëpamjen tuaj se çfarë do të bëjë privati dhe çfarë shteti, atëherë kot që po zgjatemi. Kjo është për procedurë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, shumë i saktë!

Urdhëroni!

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Te pika 5 e këtij neni thuhet: “Këshilli i Ministrave mund ta autorizojë korporatën të kryejë funksione të tjera, sipas legjislacionit në fuqi”. Cilat janë këto funksione të tjera që mund t’i kryejë korporata?

Arben Ahmetaj – Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund t’ju jap unë një shembull, zoti Saimir?

Këshilli i Ministrave, në bazë të legjislacionit në fuqi, i thotë korporatës: “E nderuar korporatë, a mund të hartoni një projektide apo projektzbatim për një aeroport, që më pas unë të ta marr,të ta blej, të ta marr hua, të ta marr pa shpërblim dhe ta hedh në proces prokurimi publik ndërkombëtar”. Kjo mund të ishte një nga ato. Jo pa qëllim, siç ju referuat, thotë: “të kryejë funksionet e tjera, sipas legjislacionit në fuqi”.

Faleminderit!

Vullnet Sinaj – Zoti kryetar, unë nuk mora përgjigje.

Arben Ahmetaj – Kjo është përgjigjja.

Vullnet Sinaj - Kjo është përgjigjja!

Arben Ahmetaj – Po nuk more, mund të votosh kundër ose pro. Nuk ka variant tjetër.

Vullnet Sinaj – Unë jam kundër një pike, por jo kundër gjithë nenit. Ta sqarojmë këtë gjë,sepse ajo, që thatë ju, është sqaruar më vonë, pra që korporata ka për detyrë të ndërtojë dhe të hartojë projekte të ndryshme, të ndihmojë edhe të tjerët. Pse duhet shkruar këtu? A mund të më sqaroni?

Arben Ahmetaj – Pra, ligji e autorizon Këshillin e Ministrave që, në bazë të legjislacionit aktual, në fuqi, të autorizojë korporatën me funksione të tjera.

Vullnet Sinaj – Nuk jam i qartë.

Arben Ahmetaj – Është rëndom në legjislacion që, brenda kuadrit ligjor makro, i jepet mundësia Këshillit të Ministrave për funksione specifike në rastin konkret, siç i ka dhënë me VKM. Për shembull, por nuk vlen për këtë rast, siç i ka dhënë dikur OSHEE-së të shpërndajë subvencionin X të energjisë, por nuk vlen në rastin konkret; thjesht e ilustrova.

Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – Kam një pyetje në lidhje me pikën 4: “Me autorizim të Këshillit të Ministrave korporata merr rolin e zhvilluesit për zonat ekonomike”.

Arben Ahmetaj – Po.

Edlira Hyseni – Kjo i jep një mundësi, ose një status të privilegjuar korporatës, nëse për këto zona ekonomike konkurrojnë edhe operatorë privatë, apo subjekte të tjera? Pra, do të ketë përparësi, si do të jetë e garantuar mundësia për të tjerët për t'i zhvilluar këto zona?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Pyetje e saktë.

Ju falënderoj për pyetjen!

Ia jap vetë përgjigjen, zoti Zëvendësministër.

Ka raste, siç ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti deputet, nga ju merr shembull i gjithë grupi, unë po e po, për disiplinë...

Ka një rast specifik për ta furnizuar si argument të drejtë tuajin: hapëm Spitallën, nuk funksionoi për 1 milion arsye teknike, procedurale apo ligjore, nuk ka rëndësi dhe nuk po i hyj asaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Politike mendon ti, por unë mendoj se më shumë janë ekonomike. Atëherë, qeveria e autorizon korporatën që ta zhvillojë. Pse?! Sepse është pjesë e zhvillimit ekonomik të vendit dhe, në finale, është projekt me përfitueshmëri, pra nuk është projekt që subvencionohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. Ju lutem, ta mirëkuptojmë njëri-tjetrin dhe ta dëgjojmë. Ajo që thashë unë është kur dështon procedura e tenderimit. Pra, shiko çfarë thuhet: “me rolin e zhvilluesit”. Në qoftë se nuk është zhvilluar... Besoj se e dini që bashkitë e kanë marrë rolin e zhvilluesit me ligj. Tani po e bën Bashkia e Tiranës.

Urdhëroni!

Artur Roshi – Për sa i përket marrjes së rolit të zhvilluesit, pyetja është: ne e zhvillojmë tregun me urdhër të qeverisë, me urdhër të korporatës, si e zhvillojmë tregun, apo çojmë në treg atë që kërkon tregu? Sepse themi që rregullatori është kërkesë-oferta dhe zhvillimet nuk mund të bëhen se i teket ministres së Ekonomisë, drejtorit apo bordit për të zhvilluar një pronë, e cila nuk mund të mos japë sukses në zhvillimin e saj. Pra, mund të mos funksionojë investimi që është bërë. Domethënë, po hapin një gropë potenciale-ekonomike në dëm të ekonomisë shqiptare.

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Zoti kryetar, për këtë projektligj kemi diskutuar në një seancë të gjatë me pyetje-përgjigje; janë ngritur propozimet apo rekomandimet nga Komisioni

European për riformulime të caktuara. Mendoj se vazhdimi i humbjes së kohës, për sa kohë nga ana e opozitës ka një votë kundër, nuk i shërben askujt. Nuk mendoj se kemi qartësi duke vazhduar të bëjmë pyetje, që nuk janë fare në objektin e këtij projektligji. Të diskutosh për dështime, të diskutosh për PPP-në, ndërkohë që jemi duke folur për një projektligj për korporatën, ata të mendojnë që është humbje kohe.

Si përfaqësuese e Komisionit të Ekonomisë do t'u lutesha dhe do t'u bëja thirrje kolegëve të opozitës të ngrenë shqetësime që kanë të bëjnë me projektligjin. Qeveria, maxhoranca ka politika të caktuara që funksionojnë në ligjet e ekonomisë për të orientuar ata sektorë që sjellin rritje ekonomike. Nëse që në krye të herës e keni me idenë që kjo është e dështuar, mos na humbisni kohën, sepse as qytetarët nuk po sqarohen, madje, më keq, po orientohen gabim për këtë projektligj të rëndësishëm.

Do t'ju lutesha sërish të orientojmë të gjitha pyetjet tona në lidhje me sqarimet që kanë të bëjnë me këtë projektligj, dhe jo me bindjen tuaj që keni të bëni me PPP-të apo me dështimin. Jemi Komisioni i Ekonomisë dhe duhet të fillojmë të diskutojmë për sa i përket ekonomisë, jo bindjeve personale politike.

Arben Ahmetaj – Më falni!

Do t'ju lutesha të mos u ndërhyjni kolegëve gjatë fjalës, siç nuk ju ndërhyhet edhe juve. Respektoni njëri-tjetrin që edhe vetë të dëgjojmë, edhe qytetarët të qartësohen, por edhe ministria të ndjekë logjikën.

Fjala për zotin Bici.

Dritan Bici - Mbështes shqetësimet e kolegëve të opozitës, sepse kemi të bëjmë me një temë shumë të rëndësishme, dhe nocionet ekonomike ndoshta nuk i njohim të gjithë. Këtu në komision ka potenciale, duke filluar nga ju, që jeni ish-ministër i Ekonomisë dhe nga pedagogët e ekonomisë, formoni një korporatë investimesh me tabela që ta kuptojmë të gjithë që të mos kemi pyetje të tilla, sepse kemi të bëjmë me një element të ri. Ne njohim vetëm shoqëritë aksionere me një nivel dhe dy nivele. Si do të krijohet kjo shoqëri aksionere, do të ketë vetëm asamblenë e aksionerëve, apo do të ketë edhe këshillin mbikëqyrës? Kush e ka paketën kontrolluese në këtë shoqëri aksionere e të tjera? Ka shumë probleme, kështu që nuk keni pse të nxitoheni.

Arben Ahmetaj – Propozimi i zotit Bici është shumë dinjitoz. Tabelat i keni këtu në krah dhe drafti është shumë i qartë. Jam i bindur, zoti Bici, që ju e kishit lexuar në detaje ligjin dhe besoj se këto pyetje i bëni për të qartësuar të tjerët, se vetë më rezultuat i qartë dhe ju falënderoj për vërejtjen. Patjetër, do t'i bëni pyetjet në vazhdimësi nen për nen.

U tërheq vërejtje deputetëve!

Pra, do t'ju lutesha, kolegë deputetë, të fokusoheni te nenet dhe teknikalitetet, sepse qëndrimet në parim politiko ekonomike konceptuale i kemi kaluar herën tjetër dhe, në legjitimitet të çdo përfaqësimi politik, secili ka mbajtur qëndrimet e veta. Mbledhja vazhdoi 2 orë e gjysmë, i thatë, opozita, pozita, dhe unë në legjitimitet tuajin sot duhet të jemi Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të fokusohemi tek teknikalitetet e ligjit. Nëse ka kontribute për ta përmirësuar, do t'ju lutesha që t'i ndani me ne që t'i përmirësojmë. Nëpërmjet pyetjeve të fokusuara te nenet, të sqarohemi për ato, siç u referua zoti Bici, mund të ketë edhe çështje që duhen sqaruar më tej.

Kush është pro për nenin 5 të riformuluar, të shtuar...?

Krenar Ryçi - Faleminderit, zoti kryetar!

Referuar nenit 5, pika 1, “Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave”, për çfarë pronash bëhet fjalë që do të menaxhojë kjo korporatë? Si dhe me çfarë fondesh? Si duhet të jetë bashkëpunimi me privatët? Duhet ta bëjmë të qartë edhe për qytetarët nëse kjo korporatë është e dobishme në funksionin e saj dhe si do të menaxhohet në lidhje me ta dhe pronat e tyre?

Arben Ahmetaj – Zoti zëvendësministër, përgjigja të fokusohet te neni 5, jo te konceptualet, sepse është e njëjta pyetje, që deputeti në respekt të tij dhe të thellësisë së njohjeve ekonomike, e bëri edhe herën e kaluar. Kështu që do të lutem, teknikisht përgjigjen.

Elton Haxhi – Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave ka të bëjë me prona shtetërore, jo prona private. Ky zhvillim do të bazohet mbi studimin e fizibilitetit dhe një projekt të plotë, që do të bashkëfinancohen. Pra, neni 5 është ezaurues për sa u përket funksioneve të korporatës. Ndërsa menaxhimi i përditshëm është detyrë e organeve drejtuese se si do t'i analizojnë këto projekte.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Ka pyetje për nenin 5?

E hedhim në votim këtë nen me ndryshimet që janë propozuar në tabelën që ju shoqëron gjatë punës së komisionit. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 6 “Burimet financiare”. Do t'ju lutesha të ndiqni tabelën, në mënyrë që të jemi të qartë për çka do të ndryshojmë.

Unë po e lexoj të gjithë nenin 6.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni! Jo, 5 është bërë 6!

- “Korporata mund të financohet nga buxheti i shtetit për kapitalizimin.
- Kontributi i institucioneve financiare ndërkombëtare, të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e saj dhe shërbimet e ofruara, donacionet në përputhje me legjislacionin në fuqi, burime të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e saj të brendshme.
- Financimi i korporatës nga buxheti i shtetit do të jetë në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore.
- Detyrimet financiare të korporatës. (Të nderuar deputetë, do të doja ta fokusojmë këtë pikë që të davarisni shqetësimet për PPP-të apo për gropa)

Detyrimet financiare të korporatës nuk i transferohen buxhetit të shtetit. Përgjegjësia për shlyerjen e detyrimeve financiare është detyrim i korporatës”.

Pra, i thamë ato shqetësimet tuaja politike, tani teknikisht, zoti Roshi...

Zoti Bici, zoti Roshi ka një status specifik, që ia kemi dhënë të gjithë, kemi votuar jashtë kamerave. Ai do të bëjë pyetje dhe komente për çdo ligj dhe për çdo nen në çdo lloj këndvështrimi sa herë t’i dojë qejfi. Kështu që do t’ju lutesha, pasi të mbarojë ai, kërkojeni fjalën.

Artur Roshi – Mua më mjafton statusi i deputetit, megjithatë, ju falënderoj për zemërgjerësinë! S’do të ndryshoj asgjë nga qëllimet e mia politike apo ekonomike.

Pyetja ime për nenin 6 është: financimi i korporatës nga buxheti i shtetit, që thoni këtu, duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore; kapitalizimi bëhet nga fondi i buxhetit të shtetit. Pyetja ime është: në qoftë se kjo korporatë falimenton, e kujt është përgjegjësia? Është njësoj si firmat piramidale kjo?

Arben Ahmetaj – Mos u angazho, zoti zëvendësministër! Shlodhu pak, se je lodhur shumë këto kohë!

Buxheti i shtetit për kapitalizimin: “Korporata mund të financohet nga buxheti i shtetit për kapitalizimin e saj”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, zoti Roshi ka një propozim, nga çfarë kuptova unë, por do të ma korrigjojë nëse e kam kuptuar gabim. Ai propozon që buxheti të financojë edhe në vazhdim. Unë jam kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, por çfarë thatë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, po i përgjigjem unë pyetjes. Jo, nuk ekziston ai rrezik dhe përgjegjësinë e ka...

Nëse do të falimentonte korporata, ajo që është e rëndësishme, asnjë detyrim nuk i kalon buxhetit të shtetit, dhe e dyta, kur një ndërmarrje falimenton, sigurisht që është përgjegjësi e drejtpërdrejtë administrative e menaxhimit të vetë në rastin konkret, por të falimentojë një korporatë shtetërore, patjetër që qeveria dhe shteti ka përgjegjësi, nuk diskutohet.

Faleminderit!

Edlira Hyseni – Me gjithë respektin për zëvendësministrin, se jemi edhe kolegë, auditues të pavarur, kështu që e njoh shumë vite përpara...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Riformuli që i është bërë ligjit me ndryshimin, e ka specifikuar më qartë se si shteti do të kontribuojë në korporatë. Kontributi i shtetit është në kapitalin fillestar dhe në çdo rast eventual rritet kapitali më pas. E kemi të qartë?

Si masë e relacionit parashikohet që kapitali fillestar të jetë diku te 3 milionë euro dhe më tej nuk ka ndonjë informacion tjetër të aspektit financiar. Pyetja ime është: në mbledhjen e kaluar, në mos gaboj, referuat për një listë fillestare pronash shtetërore që janë tashmë të parashikuara të jenë si kapital te korporata. A mund të kemi një informacion më shumë se cilat janë këto? Unë personalisht nuk e kam kuptuar mirë se cili është fokusi real i korporatës, cilat janë pronat konkrete që mund të zhvillojë, ose çfarë ka identifikuar tashmë. Ndaj pyetjen e parë e kam lidhur me këtë: a ekziston ajo listë pronash fillestare dhe cilat janë?

Arben Ahmetaj – Më falni, një pyetje kam, zonjë!

Ku është kjo pyetje, te cila pikë?

Edlira Hyseni – Pyetja ime është te pika e parë, “Buxheti i shtetit për kapitalizimin e saj”. Kemi një informacion që kapitali fillestar do të jetë 3 milionë euro dhe nga çfarë na është thënë, ka një listë pronash që do të doja...

Arben Ahmetaj – Ku është pyetja juaj brenda nenit 6?

Edlira Hyseni – Kjo është pyetja: a mund të kemi informacion për këtë investim kontribut shtetëror...

Arben Ahmetaj – Mbajeni shënim, zoti zëvendësministër, dhe kthejini përgjigje me shkrim zonjës për listën e mundshme nesër.

Edlira Hyseni – Pyetja e dytë: germa “e” “Burime të tjera të financimit të korporatës”. Keni ndonjë ide se çfarë janë këto?

Cilat mund të jenë burimet e tjera eventuale për të përjashtuar mbështetjen e të tjera, të cilat mbeten burime të tjera.

Pyetja e fundit në lidhje me financimin e korporatës në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore, nga që jo të gjithë e njohin ligjin e ndihmës shtetërore, a ka ndonjë lloj ideje sa mund të jetë në vlerë e kuantifikuar ky lloj kontributi, sipas legjislacionit të ndihmës shtetërore që do të jetë në vijim?

Gjithashtu, detyrimet financiare nuk i transferohen buxhetit të shtetit, kjo është e mirë, por ka dilemat e veta.

Arben Ahmetaj- Ju lutem, na e përmirësoni si formulim, nëse mundeni!

Edlira Hysenaj -Është në parim kjo gjë, por përgjegjësia për shlyerje i takon korporatës. Cilat janë mekanizmat e monitorimit, që janë menduar të burimet e financimit e të tjera?

Arben Ahmetaj– Kjo është pyetje që nuk është pjesë e këtij neni.

Edlira Hysenaj- Dakord, e tërheq.

Arben Ahmetaj- Mbani shënim, zëvendësministër, do t'i jap një përgjigje unë zonjës deputete, për ndihmën shtetërore nuk ka kuantifikim. Ndihma shtetërore në radhë të parë është parim, pastaj është shifër, sepse mund të jetë 1, 10, 200. Nuk është e thënë se është 1, dhe është pak, i lejohej nëse ka shkelur parimet ndihmës shtetërore.

Zoti zëvendësministër.

Elton Haxhi- Në lidhje me listën.

Arben Ahmetaj – Nuk jemi të interesuar për listën, kur ta keni, dërgojeni, bëjeni publike në website, silleni, por mos na ktheni përgjigje për një gjë që nuk ekziston.

Elton Haxhi- Te burimet e financimit përveç kapitalit fillestar ose shtesave në kapitalin e korporatës nga buxheti i shtetit janë parashikuar donacione dhe burime të tjera, të cilat mund të jenë të ngjashme me donacionet, por, gjithsesi, do të jenë pjesë e marrëveshjeve që do të lidhë korporata dhe do të kalojnë si kapital i korporatës.

Vullnet Sinaj – Korporata mund të financohet nga të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e saj dhe shërbimet e ofruara. Në këtë mënyrë si ishte formuluar kjo duket sikur të gjitha të ardhurat e korporatës shkojnë për rifinancimin e korporatës. A do të shkojë ndonjë gjë në buxhet të shtetit nga këto të ardhura? Kështu që unë mendoj se duhet formuluar ndryshe, një pjesë e të ardhurave sipas vendimit të bordit ose kush e ka të drejtën më poshtë apo të këshillit mbikëqyrës të ndahet se do të ketë një bilanc në fund të vitit, nga i cili do të vendoset se një pjesë e të ardhurave do të kalojë për rifinancim dhe një pjesë do të shkojë në

buxhetin e shtetit, sepse, si është formuluar aty, del që do të rifinancojë vetveten çdo vit. Ka një qëllim ndërtimi i kësaj korporatë, të ardhurat duhet të ndikojnë direkt në përmirësimin e buxhetit të shtetit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Buxheti i shtetit përfiton nga disa drejtime: rritja e zhvillimit ekonomik, ku kontribues mund dhe do të jetë edhe korporata, e cila ka zinxhirin e vet përfitues për buxhetin e shtetit.

Së dyti, është shoqëri tregtare, do të funksionojë si shoqëri tregtare dhe do të paguajë taksa dhe tatime në bazë të legjislacionit në fuqi dhe, nëse bordi vendos të mos shpërndajë dividend, nuk do të shpërndajë dividend, do t'i hedhë paratë për investime.

Prandaj, propozimi që Vullneti bën, në këndvështrimin tim personal, nuk qëndron, por do ta votojmë.

Na e thoni propozimin, zoti Vullnet, që ta votojmë!

Vullnet Sinaj – Propozimi im është: një pjesë e të ardhurave të aktivitetit të saj të jetë pjesë e financimit të korporatës, sepse një pjesë mund të kalojë në buxhetin e shtetit, nuk ka pse të rifinancohet me të gjithë vlerën.

Arben Ahmetaj- Kush është pro? Kundër? Abstenime?

Nuk miratohet.

Zoti Bici.

Dritan Bici – Nëse kjo korporata e investimeve shqiptare do të ishte krijuar para 10 vjetësh, do të ishte një rast shumë i mirë rasti i investimeve në kaskadën e hidrocentralit të Banjës, ku shteti shqiptar kishte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zoti Vullnet, ju lutem, mos ndërhyini, sepse zoti Bici ju respektoi.

Dritan Bici – Nëse kjo korporatë do të ishte miratuar para 10 vjetësh investimi i bërë mbi lumin Devoll do të ishte 100% një investim shqiptar sot, sepse aty ndoshta 30-40% e punimeve ishin të bëra nga shteti i kohës së monizmit, dhe një grup investitorësh fare mirë mund ta kishin mbyllur nëpërmjet kësaj korporate, dhe kapitali do të ishte 100% shqiptar në atë hidrocentral, i cili sot prodhon 80 mega, të cilat do të ishin në favor të tregut shqiptar.

Arben Ahmetaj – Zoti Bici, jemi duke diskutuar nenin 5. Kush ka pyetje tjetër për nenin 5?

Nuk ka, faleminderit!

Votohet neni 6 me ndryshimet në tabelë.

Kush është pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te neni 7.

Pra, neni 6 ekzistues, sipas sekretarisë, bie, apo jo?

Pra, neni 6 i variantit të parë zyrtar, që ka ardhur nga Këshilli i Ministrave dhe u zëvendësua me nenin 6 që diskutuam tani. A jeni të qartë?

Atëherë, kalojmë te neni 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, neni 7 i dikurshëm u bë neni 5. Pra, a jeni të qartë në zhvendosjen e neneve?

Tani kemi nenin 7 të variantit të ri që është “ Transferimi i pronave shtetërore”

Suzana Topi- Në nenin 7 përcaktohet se korporata e investimeve, pasi identifikon pronat shtetërore të kapitalit shtetëror ose të pushtetit vendor, i transferon këto prona ose i menaxhon ato. Pyetja ime është: a e cenon kjo pushtetin vendor? Nëse pushteti vendor ka një projekt tjetër paraprak për zhvillimin e këtyre pronave dhe në këtë kohë ndërhyjnë korporata sepse do ta për dorë për një qëllim tjetër, atëherë kush ka prioritet?

Arben Ahmetaj- Pyetje me vend. Atëherë, përpara vajtjes në këshillin bashkiak, ka ligje specifike të pushtetit vendor që i referohen transferimit të pronës nga pushteti vendor te pushteti qendror në rastin konkret, të cilat bëhen në të gjitha format pa shpërblim, me shpërblim varet nga marrëveshja. Pra, ky ligj do të afektojë edhe këtë lloj transferimi prone.

Arvit, Saimir, a jam korrekt?

Suzana Topi- Në fakt, cila ishte përgjigjja?

Arben Ahmetaj- Transferimi i pronës nga pushteti vendor te pushteti qendror bëhet në bazë të ligjeve aktuale në fuqi. Pushteti vendor refuzon ose mund ta refuzojë pushtetin qendror, mund ta japë pa qira, mund ta transferojë, mund të mos e japë fare, mund ta japë kundrejt shpërblimit. Pra janë të përcaktuara.

Krenar Ryçi – Pronat shtetërore, në kuptimin e këtij ligji, janë pronat e luajtshme dhe të paluajtshme. Për çfarë pronash bëhet fjalë? Këtë ta dinë edhe qytetarët, pra cilat janë pronat e luajtshme dhe të paluajtshme?

Arben Ahmetaj – Zoti zëvendësministër, së pari, merret leje, së dyti hapet mikrofon!

Çdo fjalë juaja është e shtrenjtë dhe e mirëkërkuar për komisionin.

Elton Haxhi- Është e njëjta pyetje me pyetjen e zonjës deputete, që do të trajtohet më vonë dhe VKM-ja që do të nxirret për këtë qëllim do të japë edhe listën, e cila do të kalojë

si kapital, ose në përdorim të korporatës. Disa nga pyetjet lidhen me çështje të administrimit dhe menaxhimit të korporatës. Ky projektligj është kuadri rregullues i korporatës, por për çështje të administrimit se çfarë do të bëjë korporata, si do t'i përdorë pronat, si do t'i vlerësojë dhe si do t'i investojë janë disa çështje që do t'i zgjidhë drejtimi i korporatës, drejtori ekzekutiv dhe këshilli mbikëqyrës. Ne do të qëndrojmë këtu dhe nuk mund të shkojmë më tej se çfarë do të bëjë korporata me ato prona.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj - Asgjë nuk ka të fshehur në Republikën e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, jepni një shembull, zoti zëvendësministër!

Elton Haxhi- Një port i harruar në bregdetin shqiptar, i cili nuk përdoret prej vitesh, që mund të ketë qenë një port ushtarak shumë vite më parë dhe nuk është më në përdorim, ose një tokë e cila nuk ka pasur asnjëherë interes për të zhvilluar turizmin, ose infrastruktura është e vështirë për t'u lidhur me pjesën tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj- Po pse nxjerr konkluzion, ku është oferta e pa kërkuar këtu?

Nene 7. Kush është pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te neni 8 “Mbështetja me infrastrukturë ndihmëse”.

Pra, nenet 9 dhe 10 të variantit të parë të ardhur nga Këshilli i Ministrave rrëzohen. Kush është pro kancelimit të neneve 9 dhe 10 të variantit të parë? Kundër? Abstenime?

Bien të dy nenet.

Tani kemi nenin e ri 9 “Marrja e licencave dhe e lejeve”.

Pra, neni 11 është bërë neni 8, “Mbështetja me infrastrukturë ndihmëse”.

Kush ka pyetje për nenin, siç është ndryshuar?

Suzana Topi - Neni 8 thotë se korporata mund të mbështetet me infrastrukturë ndihmëse në ujësjellës, kanalizime, elektrifikim komunikacion. Ky projekt i mbështetjes nga ana e institucioneve shtetërore do të jetë vlera më e madhe se projekti që faktikisht korporata do të investojë. Atëherë, si do të procedohet?

Arben Ahmetaj – Pyetja është jashtë nenit...

Zonjë, u bëtë deputete e vjetër në këtë komision, si mund të vini direkt gishtin dhe të flisni...

(Diskutime pa mikrofon)

Ka disa rregulla.

... 5, por logjikisht po ju jap një shembull, në rast se bëhet zhvilluesi i 8-ës, pra i zonës ekonomike dhe nuk ka rrugë akses, atëherë korporata thotë nuk ia delegon rrugët e Republikës së Shqipërisë, sidomos nacionalet, janë përgjegjësi e buxhetit të shtetit dhe jo të korporatës, po zhvilloj 8-ën, nuk kam rrugë akses, më duhet energjia që të punojë ndërmarrja iks apo ipsilon. Praktikisht, vlerësohet dhe bëhet.

Pyetja juaj, nëse është më pak apo më shumë, nuk është gjykim i këtij ligji, por ky është një gjykim, të cilin rasti pas rasti e ndërmerr ministri përgjegjës i Ekonomisë në raport me korporatën dhe ministrin e Financave në bazë të mundësive.

A ka pyetje tjetër.

Po zonjë.

Edlira Hyseni – Pyetja që kam unë mbetet pak a shumë e njëjta, por Suzana nuk e saktësoi mirë. Këtu thuhet që ministria vlerëson koston e përafërt të infrastrukturës ndihmëse, e cila nuk duhet të jetë disproporcionalisht e lartë në raport me vlerën dhe rëndësinë e projektit. Përmbajtja kuptohet, por a nuk ndonjë mënyrë për ta saktësuar në vlerë, në përqindje deri në sa për qind duhet të jetë vlera të projektit të infrastrukturës mbështetëse? Si do të gjykohej? A është i rëndësishëm, apo jo? A është vlerë e lartë, apo jo? Në këtë mënyrë duket sikur është subjektive.

Arben Ahmetaj – Faleminderit për pyetjen, e cila është shumë e saktë! Përgjigja është, ne prandaj autorizojmë qeverinë, bordin dhe korporatën të gjykojnë, prandaj ligjet në përgjithësi, përveç disa ligjeve specifike, të cilat u referohen parimeve, disproporcionalisht më e lartë. I lihet qeverisë, ministrit të Ekonomisë, ministrat të Financave, bordit të korporatës që ta gjykojnë.

Faleminderit!

A ka pyetje tjetër?

Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Kush është pro neni 8 me ndryshimet? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9 që ka qenë neni 12. Neni 12 i variantit të parë bëhet neni 9 i variantit të përmirësuar.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet spostimi i neni.

Neni 9 i riformuluar “Marrja e licencave të lejeve”.

Po, zonja Hyseni.

Edlira Hyseni – Në ndryshimet që i keni bërë këtij neni është hequr specifikimi i rastit kur institucionet nuk kthejnë përgjigje brenda afateve 15 apo 30-ditore. Në rastet kur institucionet nuk kthejnë përgjigje për marrjen e licencave dhe të lejeve si do të rregullohet konkretisht?

Në variantin e parë ka pas qenë që merrej e mirëqenë në heshtje miratimi i tyre, ndërsa në variantin përfundimtar ky rast është hequr. Nëse institucionet nuk kthejnë përgjigje brenda afatit çfarë bën korporata me këto leje, i merr të mirëqena apo...?

Arben Ahmetaj – Pyetje e drejtë.

Elton Haxhi – Sipas legjislacionit në fuqi, nëse nuk kthejnë përgjigje, nuk konsiderohet e miratuar në heshtje.

Arben Ahmetaj – Kjo është arsyeja pse është specifikuar këtu.

Pra, kjo e detyron administratën që për 15 ditë, në rastet specifike 30 ditë, të kthejë përgjigje, por është shumë e rëndësishme, sepse nuk quhet e miratuar. Kjo gjëja është shumë e rëndësishme.

(Diskutime pa mikrofon)

E drejta administrative ekziston, por jo për korporatën, e kemi përjashtuar korporatën nga kjo e drejtë. Apo nuk është kështu zoti zëvendësministër?

E drejta e miratimit në heshtje është pjesë e legjislacioneve organike, sidomos, Arvid, e Kodit Administrativ. Këtë të drejtë ia kemi hequr korporatës, ky është thelbi i nenet, por kemi detyruar administratën që të përgjigjet për 15 ditë dhe në raste specifike për 30 ditë.

Faleminderit!

Kush është pro neni 9 të riformuluar? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10, i cili ka qenë neni 13. Kush është pro spostimit të neni 13 në neni 10? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, është i riformuluar, por më pas do të vij te formulimi.

Miratohet.

Pra, neni 13 i variantit të parë bëhet neni 10 i variantit të rishikuar “Regjimi i prokurimit”. Kush ka pyetje?

(Diskutime pa mikrofon)

Media, regjistrojeni që nuk kishte asnjë pyetje. Në regjimin e prokurimit publik janë rrëzuar të gjitha ato debate politiko-joeconomike që ka bërë në vazhdimësi, lloj-lloj entitësh apo pseudospecialistësh. Po e lexoj për qytetarët “Regjimin e prokurimit” në të cilën thuhet: “Për kontratat publike, të cilat financohen plotësisht nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, zbatohen rregullat e prokurimit që parashikohen nga kjo organizatë ose institucion. Në rastin e kontratave publike, që bashkëfinancohen në shumicën e tyre nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurën e zbatueshme të prokurimit. Për kontratat publike, të cilat financohen nga buxheti i shtetit zbatohen dispozitat e ligjit “Për prokurimin publik” në fuqi”.

Faleminderit!

Kush është pro? Kundër?

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Roshi, nuk e bëjmë pa tendera. Ti mund ta kesh në rregull...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk e kishit për këtë nen, atëherë jemi në rregull.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11, i cili ka qenë neni 14.

(Diskutime pa mikrofon)

Flisni për veta apo për të gjithë?

(Diskutime pa mikrofon)

Pjesa e opozitës ka autorizuar zonjën Gjylameti që t’i bëjë pyetjet?

(Diskutime pa mikrofon)

Me autorizim të komisionit, zonja Gjylameti, vazhdoni bëni pyetjet në emër të...

(Diskutime pa mikrofon)

E keni në tryezë nenit e riformuluar, neni 14 është bërë neni 11. “Strukturat organizative”, kreu III, “Organet drejtuese të korporatës”. Organet drejtuese të korporatës janë: Asambleja e Përgjithshme, ishte një pyetje që bëri më përpara zoti Bici, por edhe anëtarë të tjerë të komisionit, këshilli Mbikëqyrës, Drejtori Ekzekutiv dhe Bordi Këshillimor.

A ka ndonjë pyetje? Nuk ka.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 11.

Neni 12 “Asambleja e Përgjithshme” i variantit të riformuluar, sepse nuk është e nevojshme t’jua them numrat.

Kush ka pyetje?

Po, zoti Vullnet.

Vullnet Sinaj – Sa i takon Asamblesë së Përgjithshme, thuhet të gjitha detyrat e saj, çfarë kryen si detyrë, por nuk thuhet se kush merr pjesë tek asambleja e përgjithshme ose sa pjesëtarë janë.

Arben Ahmetaj – Më falni!

Zoti zëvendësministër, mos guxoni të përgjigjeni!

I keni te nenet vijuese.

Edlira Hyseni – Nuk e ka, jo!

Arben Ahmetaj – Prisni!

Vullnet Sinaj – Në nenet vijuese kemi këshillin mbikëqyrës, kompetencat e këtij këshilli, bordin, drejtorin ekskluziv, por për asamblenë e përgjithshme nuk thuhet se kush merr pjesë dhe nga sa persona përbëhet.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – E thotë ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, vetëm një asamble, siç është sot shpesh!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, po.

E hedhim në votë edhe një herë nenin 12, bashkë me riformulim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13 “Këshilli mbikëqyrës”. Ka pyetje? Nuk ka. Kush është pro? Kundër?

Edlira Hyseni – Më falni, kam një pyetje!

Arben Ahmetaj – Patjetër. Më falni që e vazhdova.

Edlira Hyseni – Nuk po e ndjek dot radhën, pasi po ecni shpejt.

Në mos gaboj, te këshilli mbikëqyrës, në variantin e parë ishte kushti që një anëtar të ishte përfaqësues i institucioneve shtetërore dhe është hequr? Pse është konsideruar me rëndësi të hiqet detyrimi që në këshillin mbikëqyrës (që do të jetë edhe fillestari, i miratuar nga asambleja), pra është hequr kushti që një anëtar të jetë përfaqësues i institucioneve shtetërore dhe është lënë thjesht pesë anëtarë të pavarur, a diçka e tillë?

Arben Ahmetaj – Sepse menduam që është më transparente të jetë i pavarur.

Faleminderit!

Kush është pro neni 13? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14 “Kompetencat e këshillit mbikëqyrës”, sipas variantit të riformuluar.

Zonjë, keni pyetje? Nuk keni.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe neni 14.

Vijojmë me nenin 15 “Drejtori ekzekutiv”, sipas variantit të rishikuar. Ka pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni propozim?

Vullnet Sinaj – Meqenëse drejtori ekskluziv, te neni 15, i ka të gjitha përgjegjësitë e një administratori të një kompanie, pse të mos e quajmë administrator dhe të mbajë të gjitha përgjegjësitë ligjore që i takojnë një administratori?

Arben Ahmetaj – Sepse është shoqëri anonime.

Vijojmë me votimin e neni 15. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16 “Kompetencat e drejtorit ekzekutiv”, sipas variantit të rishikuar. Ka pyetje?

Nuk ka. Kush është pro me variantin e rishikuar? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17, sipas variantit të rishikuar. Ka pyetje? Nuk ka. Kush është pro? Kundër?

Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I shënon kundër? Ti je kundër për të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, po, për këto, jo për të gjitha, se kështu...

Vijojmë me nenin 18 “Administrata”, sipas variantit të rishikuar. Ka pyetje? Nuk ka.

Faleminderit!

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te kreu IV “Kontabiliteti dhe auditimi i pasqyrave financiare”.

Neni 19 “Kontabiliteti dhe llogaritë vjetore”, sipas variantit të rishikuar. Ka pyetje? Nuk ka. Faleminderit! Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20 “Auditimi i pasqyrave financiare”, sipas variantit të rishikuar. Ka pyetje?

Po, zonjë.

Edlira Hyseni – Atëherë, në radhë të parë, e çmoj të rëndësishëm ndryshimin që i është bërë variantit final, ku, besoj, sipas rekomandimeve të Komisionit European, është shtuar pika me këtë përmbajtje: “Kontrolli i Lartë i Shtetit ka detyrimin për të bërë auditimin e përdorimit të administrimit të fondeve dhe pronës publike”, pasi shtimi i kësaj pike të lë të kuptosh se për çfarë bëhet fjalë dhe se sa e rëndësishme është kjo korporatë, për të cilën po diskutojmë sot në parim ose nen për nen.

Dakord që Kontrolli i Lartë i Shtetit është një hallkë monitoruese, kontrolluese shumë e mirë dhe do të kryejë këtë auditim, por pyetja konkrete këtu do të ishte: a parashikohen afate? Domethënë, do ta ketë detyrim auditimin, çdo vit të këtyre pasqyrave financiare, menaxhimin apo raportin e veprimtarisë? A ka një përcaktim të saktë se si Kontrolli i Lartë i Shtetit do ta auditojë korporatën?

Meqenëse jam te pika që ka të bëjë me auditimin e pasqyrave financiare, gjë që, siç e thashë, ne e njohim mirë në praktikë, se auditimi bëhet gjithnjë brenda një segmenti të njëjtë, të mirëpërcaktuar të audituesit, do t’ju ftoja sinqerisht të bënit një konkurrim më të hapur, më të ndershëm, në mënyrë që të afroni auditues të tjerë për pasqyrat financiare, të cilët, pa dyshim, do të bënin një punë më cilësore, më ekonomike, por edhe më të besueshme për palët e treta. Ky është opinion lidhur me auditimin.

Për sa i përket Kontrollit të Lartë të Shtetit, do të doja të dija afatet që janë parashikuar për të kontrolluar korporatën.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Referojuni ligjit “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, zonjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e njihni? Por nuk e ka detyrim zëvendësministri...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sipas ligjit specifik, një herë në vit; sipas radhës.

Faleminderit!

Vijojmë me votimin e nenit 20.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një herë në vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sipas ligjit, pra! Por mund ta bëjë edhe dy herë në vit, ose mund ta lërë një vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Kush është pro nenit 20 “Auditimi i pasqyrave financiare”?

Faleminderit për komentimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zëvendësministri deshi të fliste?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por unë prandaj jam kryetar.

Kush është pro nenit 20? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vijojmë me kreun IV “Dispozitat e fundit”.

Neni 21 “Aktet nënligjore”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vijojmë me nenin 22 “Dispozita kalimtare” me këtë përmbajtje: “Ministria përgjegjëse për Ekonominë, brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndjek procedurat e nevojshme” dhe poshtë janë procedurat. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetje: jeni kundër, sepse e doni për 100 ditë, apo 80 ditë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka.

Në bazë të procedurës që keni bërë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbledhja e sotme ka në rend të ditës votimin nen për nen, ndërsa në parim e kaluam herën e shkuar, madje mbajtët qëndrime dinjitoze për sa i përket qëndrimit partiak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, është e paracaktuar procedura. E bëmë herën e kaluar, ku të gjitha qëndrimet konceptuale në parim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, sot e kalojmë nen për nen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka Rregullore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le të jetë sa të dojë, por e bëtë herën e kaluar.

Vijojmë me nenin 23. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi, me ndryshimet që rreshtuam një nga një.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Të më sillet raporti për firmë që më pas t'i paraqitet seancës plenare.

Falënderoj Ministrinë e Financave që u lodh! Faleminderit, kolegë deputetë!

Gjithë të mirat!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti